

VENDIM
Nr.116, datë 28.12.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK ME SERI PVO5V, NR.29, LËSHUAR ME VENDIMIN
E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.85, DATË 27.12.2005

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 13 dhe 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr.29, seria PVO5P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit, siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës nr.29, seria PVO5P, të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta